

Ç'RËNDËSI KANË DISA TË DHËNA TË MATTHIAS MURKOS PËR POEZINË GOJORE SHQIPE?

Anton Berisha

Instituti Albanologjik
Prishtinë

KUD 891.983:398.8:885.0
885.0:891.983.398.8
Punim studimor

Marrë për botim më 15 qershor 1987

Në punim trajtohen disa të dhëna të Mathias Murkos për poezinë gojore shqipe, të cilat ky studiues çek i solli në një varg punimesh në gjuhën gjermane e serbokroate si dhe veprën e tij të famshme „Tragom srpsko-hrvatske narodne epike” (1951). Mbase jepen disa të dhëna për portretin e Murkos si studiues dhe njohës i mirë i epikës gojore sllave dhe më gjerë dhe mbase paraqiten disa fakte e mendime që lidhen me punën në terren në Kosovë dhe në Mal të Zi, ku ai kishte kontaktuar me këngë dhe me këngëtarë shqiptarë madje dhe kishte mbledhur ndonjë nga krijimet epike shqipe, në punim vështrohen të dhënat për kultivimin e epikës gojore të shqiptarët, për nivelin e saj artistik, për tematikën, për traditën e këndimit herë në dy e herë në tri gjuhë, për këngëtarin e verbër — Qorr Husenin, për përkimet e epikës gojore shqipe me epikën në gjuhën serbokroate, pastaj për foljen „knaditi, sknaditi, isknaditi” etj. Në punim kontestohen, pezullohen dhe përplotësohen disa mendime të Murkos për epikën shqipe, shqyrtohen e përafrohen disa rrethana që kanë nxitur një njëanshmëri në verifikimin e fakteve nga ana e tij dhe të sjelljes së disa mendimeve të ngutshme e të paqëndrueshme për epikën gojore shqipe, me ç’rast ato vihen përballë të dhënave e argumenteve, të cilat Murkoja nuk i kishte pasur parasysh. Disa mendime vështrohen në një lidhshmëri me mendimet paraprake e të më vonshme, me ç’rast del në shesh nevoja e shqyrtimit dhe e rishqyrtimit kompleks të epikës gojore të Siujdhesës Ballkanike.

„Brenda mundësisë i kam kushtuar kujdes edhe epikës shqiptare”.

*

„Nga Serbia e Vjetër kanë mbetur analfabetë vetëm arnautët, te të cilët për këtë arsye është ruajtur mirë tradita gojore, kështu që tek ata ende 'gjithçka këndohet' dhe përherë lindin këngë të reja”.

Matthias Murko

1. Studiues dhe njohës i mirë i epikës gojore

Veprimtaria e Matthias Murko-s (Matia Murko)¹ është e gjerë dhe e shumëllojshme. Si profesor i filologjisë sllave ai punoi në universitetet e Vjenës, Lajpcihit, Gracit, ndërsa në Universitetin e Karlovit (Pragë) ligjëroi gjuhën dhe letërsinë e sllavëve të Jugut. Ishte kryetar i Institutit sllav të Pragës. Në një varg punimesh dhe recensionesh, që kalojnë suazat e filologjisë, Murkoja mori në vështrim çështje fonetike, morfologjike dhe të dialektologjisë. Është themelues i studimit krahasimtar të letërsive sllave dhe bashkëthemelues i publikimit „Worter nud Sachen” (Hajdelberg nga viti 1909). Mirëpo, emri i M. Murkos është i lidhur ngushtë dhe me studimin e epikës gojore në përgjithësi, e sidomos me studimin e epikës gojore në gjuhën serbokroate. Pikëpamjet e veta rreth kësaj epike ai i shfaqti në një varg punimesh botuar në fillim të shekullit tonë² e sidomos në veprën e tij „Gjurmëve të epikës popullore serbokroate”.³

Rëndësia e punës së këtij studiuesi dhe njohësi të mirë të epikës gojore në përgjithësi nuk qëndron vetëm në faktin se ai u mor gjatë dhe me përkushtim me epikën gojore të disa popujve të Evropës Juglindore, por pse në bazë të përvojës, që fitoi gjatë punës në terren, duke mbledhur këngët popullore në Dalmaci,

¹ Matthias Murko lindi më 10 shkurt 1861 në Drstel të Ptujit. Veprat më të njohura të tij janë: *Enklitika në gjuhën sllave, Ndikimi gjerman në fillim të romantikës sllave* (gjermanisht), *Historia e letërsive të vjetra të sllavëve të Jugut* (gjerm.), *Rëndësia e reformacionit dhe kundërreformacionit për jetën shpirtërore të sllavëve të Jugut* etj. (Sipas *Opća enciklopedija jugoslavenskog leksikografskog zavoga*, 5, Zagreb 1979, f. 618.)

² Punimin e parë rreth epikës së muhamedanëve të Bosnës (term i Murkos) ky studiues çek e botoi në gjuhën gjermane në „Zeitschrift des Vereins für Volkskunde. Hg. von Johannes Bolte. 19. Jahrgang. Berlin 1909 me titull „Die Volksepik der bosnischen Muhammedaner”. Në periudhën kohore 1909—1919 Murkoja botoi edhe disa punime në gjuhën gjermane, më vonë në gjuhën çeke etj. Veprën e tij në dorëshkrim „Gjurmëve në epikën popullore serbokroate” ia përktheu në gjuhën serbokroate JAZU dhe e botoi më 1951.

³ Matija Murko, *Tragom srpsko-hrvatske narodne epike. Putovanja u godinama 1930—1932*, Knjiga I, II, Zagreb 1951.

Bosne e Hercegovinë, në Kosovë, në Mal të Zi e në disa vise të tjera, dha një varg të dhënash të rëndësishme për gjendjen konkrete të epikës gojore dhe të tipareve të saj dhe ndriçoi shumë çështje esenciale të ekzistimit, të mënyrë së funksionimit, të rëndësisë, pastaj të rolit të këngës dhe të këngëtarëve në ruajtjen dhe zhvillimin e traditës së epikës gojore etj., që deri në kohën e Murkos nuk ishin shtruar e nuk ishin ndriçuar në një gjerësi të tillë dhe nuk ishin konkretizuar me shembuj e me të dhëna të drejtpërdrejta nga terreni, aty ku epika gojore bën jetën e saj të vërtetë.

Brenda studimit të epikës gojore serbokroate Murkoja u mor në mënyrë të veçantë me epikën gojore të myslimanëve të Bosnës dhe të Hercegovinës. Ky interesim i tij zë fill me ligjëratat në Universitetin e Gracit gjatë semestrit dimëror më 1905—1906, e sidomos me ligjëratën e mbajtur në Kongresin internacional për shkencën e historisë (mbajtur në Berlin më 1908), e cila një vit më vonë u botua e zgjeruar në „Zeitschrift des Vereins für Volkskunde” me titull „Epika popullore e muhamedanëve të Bosnës”.⁴ Në këtë punim dhe në punimet e tjera si „Berichte über eine Bereisung von Nordwestbosnien und der angrenzenden Gebiete von Kroatien und Dalmatien behufs Erforschung der Volksepik der besnischen Muhammedaner”,⁵ por edhe në veprën e tij *Gjurmëve të epikës popullore serbokroate*, ai shtroi çështje të veçorive të epikës gojore të myslimanëve të Bosnës, të tematikës e të stilit, të pikave të takimit me epikën e krishterë në gjuhën serbokroate, pastaj të ndryshimit dhe çështje të tjera që e cilësonin epikën gojore të kësaj treve gjuhësore në një periudhë të caktuar të zhvillimit dhe të funksionimit të saj.

Duke e hulumtuar epikën në gjuhën serbokroate Murkoja shtroi tezën se kjo epikë ka lindur në mjedise mesjetare feudale⁶ dhe kishte arritur deri në kohën e tij, mu për arsye se në ato vise ishin ruajtur kryesisht kushtet e tilla të organizimit shoqëror, që e stimulonin dhe e kushtëzonin bartjen dhe ekzistimin e traditës epike gojore.

Mirëpo Murkoja nuk u mor vetëm me studimin e epikës gojore në gjuhën serbokroate. Interesimi i tij shtrihej edhe në epikat e tjera gojore. Kështu, gjatë qëndrimit të tij në Rusi (1887—1889), i nxitur nga A. N. Veselovski nga Petrogradi dhe F. J. Buslajevi nga Moska, u mor me poezinë gojore e, brenda kësaj, vëmendjen e tij ua kushtoi edhe „Bylinave” dhe „Dumave” ruse.⁷

⁴ Matthias Murko, *Die Volksepik der bosnischen Muhammedaner*. Në: *Zeitschrift des Vereins für Volkskunde*. Hg. Johannes Bolte. Berlin 1909.

⁵ Botuar në *Sitzungsberichte der Kais. Akademie der Wissenschaften in Wien*. Phil. — His. Klasse. 173. Band, 3. Abhandlung. Wien 1913, f. 1—52.

⁶ Shih *Opća enciklopedija JLZ*, Zagreb 1979, f. 619.

⁷ M. Murko, *Tragom...*, e cit. f. 9.

Murkoja shfaqti interesim edhe për epikën gojore shqiptare dhe bullgare.

Edhe pse epika shqiptare nuk u bë objekt i mirëfilltë i këtij profesori çek, prapëseprapë ai dha disa të dhëna të rëndësishme për të, për ekzistimin dhe funksionimin e saj; shfaqti disa mendime që, duke marrë parasysh kohën, kanë rëndësi për historinë e letërsisë gojore shqipe e sidomos për historinë e epikës së saj. Pos kësaj ai incizoi — mblodhi edhe disa këngë epike nga këngëtarët shqiptarë dhe dha disa shënime për krijuesit dhe bartësit e traditës së epikës shqiptare si dhe mori në vështrim problemin e përkimeve tematiko-motivore të epikës shqiptare me epikat e tjera, e sidomos me epikën gojore myslimane.

2. Vështirësitë e verifikimit të disa të dhënave

Para se ta vështrojmë më për afër kontributin që dha Murkoja në fushën e poezisë gojore shqiptare, e shohim të udhës t'i themi disa fjalë për vështirësitë që dalin gjatë verifikimit të disa të dhënave të epikës shqiptare, të botuara në punimet në gjuhën gjermane dhe sidomos në veprën e tij „Gjurmëve të epikës popullore serbokroate”.

Nuk do mend se Murkoja gjithë kujdesin e vet ia kushtoi epikës në gjuhën serbokroate, përkatësisht asaj të myslimanëve të Bosnës dhe Hercegovinës, e cila, siç thotë ai vetë „për shkak se ishte interesante, ishte në qendër të vëmendjes sime”.⁸ Pra, çdo gjë tjetër rreth epikave të tjera, e po kështu edhe rreth epikës gojore shqiptare, ishte në periferi të interesimit të tij.

Ç'është e vërteta, Murkoja as në fillim të vizitave të para në Bosne e Hercegovinë (më 1909, 1912, 1914 etj.) e as gjatë udhëtimeve të tij, bërë më 1930—1932, që janë bazë për hartimin e librit „Gjurmëve të epikës popullore serbokroate”, nuk kishte ndërmend të merrej me epikën gojore shqiptare. Mirëpo gjatë punës hulumtuese në terren, gjatë kontakteve me këngëtarë dhe gjatë mbledhjes së materialeve në vise të ndryshme e sidomos në Kosovë, në Novi-Pazar, në Mal të Zi e gjetiu, epika gojore shqiptare iu imponua vetëvetiu.

Ky imponim u shpreh, para së gjithash, për shkak të sasisë dhe cilësisë së epikës gojore shqipe dhe për shkak të përkimeve tematiko-motivore të saj me epikën gojore në gjuhën serbokroate, e sidomos me epikën e myslimanëve të Bosnës dhe Hercegovinës. Shumë këngëtarë, prej të cilëve ai mori materiale në Novi-Pazar, në disa vise të Kosovës, në Mal të Zi etj. ishin shqiptarë, por, për shkak të politikës që mbretëronte midis dy Luftërave botërore, ata shpesh quheshin „myslimanë”, „turq” etj. dhe me-

⁸ M. Murko, *po aty*, f. 11.

rreshin si të tillë. Këta këngëtarë „myslimanë” shpesh këndonin në dy gjuhë: shqip dhe serbokroatisht ose siç thonin ata „arnatçe” dhe „bosançe” si, fjala vjen, Sali Uglanini, Sulejman Makiqi, Gjemail Zogiqi, Alia Fjulanini, por edhe këngëtarë të tjerë, që i përkitnin së njëjtës traditë.

Pikërisht emërtimi i disa këngëtarëve si „myslimanë”, „turq” dhe fakti se organet e atëhershme zyrtare nuk e shikonin me sy të mirë kontaktin e këtyre këngëtarëve me persona të ndryshëm, sikur ishte Murkoja e studiues të tjerë, janë dy çështje që e vësh-tirësojnë shqyrtimin e kontributit të Murkos në dritën e studimit të plotë e sa më shkencor.

Jo rrallë Murkoja i emërton disa këngëtarë si „myslimanë” edhe pse ata i përkasin traditës epike gojore shqiptare dhe se këndimin në gjuhën „bosançe” e kishin filluar më vonë. Për këtë dëshmojnë disa të dhëna të Murkos, por edhe të studiuesit amerikan, M. Parrysë, i cili po ashtu u mor me studimin e epikës gojore në gjuhën serbokroate. Në të vërtetë, gati gjithë materialin në gjuhën „bosançe” të Novi-Pazarit, botuar më 1953,⁹ që kap rreth 25000 vargje, M. Parryja e mblodhi nga këngëtarë shqiptarë.¹⁰ Po ashtu edhe këngëtarë më i njohur i Milman Parrysë, Abdulla (Avdo) Megjedoviqi, nga Bjelo Polja, prej të cilit (Abdullahu dinte 58 këngë) kishte shënuar këngën „Martesa e djalit të Smailagës”, me 12311 vargjesh — botuar më 1974,¹¹ ishte i gjakut Ferizi dhe me origjinë shqiptare.^{11a}

Shkaqet pse shqiptarët quheshin dhe konsideroheshin „myslimanë” dhe „turq” nuk e shohim të udhës t'i përmendim e aq më pak t'i marrim në shqyrtim më të gjerë. Këtu po kujtojmë vetëm faktin se një tendencë e këtillë e emërtimit të shqiptarëve si „myslimanë” dhe „turq” që është trashëguar nga kohët e më-hershme, vazhdoi midis dy Luftërave botërore, por edhe më vonë. Kështu, fjala vjen, edhe kryetari i Akademisë serbe të shkencave, më 1953, në hyrjen e veprës *Srpskohrvatske junačke pjesme*, Knji-ga II shkruan se këngëtarët si Sali Uglanini, Gjemail Zogiqi, Alia Fjulanini, Sulejman Makiqi, prej të cilëve M. Parryja i kishte

⁹ *Srpskohrvatske junačke pjesme*. Skupio Milman Parry. Uredio Albert Bates Lord. Knjiga druga. Novi Pazar: Srpskohrvatski tekstovi sa uvodom i primedbama urednika i predgovorom A. Belića. Izdala Srpska akademija nauka i Harvard University Press (SAD). Beograd i Kembridž 1953.

¹⁰ Shih më gjerësisht A. Berisha, *M. Parry për epikën gojore të Novi Pazarit*. Në: Rilindja, e shtunë 2.IV.1983, f. 12—13. dhe *Kush ishte Abdullah (Avdo) Megjedoviqi?* Në: Fjala nr. 8, 1986, f. 8—9.

¹¹ *Serbo-Croatian Heroic Songs. Collected by Milman Parry. Volume four. Ženidba Smailagina Sina*. Kazivao jo Avdo Mededović s popratnim Razgovorima s Mededovićem i drugim. Edited by David E. Bynum with Albert B. Lord. Center for the Study of Oral Literature. Cambridge, Massachusetts. 1974.

^{11a} *Po aty*, f. 15.

mbledhur këngët e botuara të vëllimit në fjalë, ishin ekskluzivisht myslimanë¹² edhe pse që të katërtët kishin pohuar vetë se janë shqiptarë (Këngëtari i pestë i M. Parrysë, Sulejman Fortiqi, materialet e të cilit botohen në vëllimin e zënë ngoje të vitit 1953 — i përket po asaj tradite).

Profesori çek, i cili ishte nisur për të hulumtuar dhe mbledhur epikën në gjuhën serbokroate, ishte gjetur në terren para vështirësive jo të vogla për cilësimin e këngëtarëve arnautë, „myslimanë” ose „turq” ose këngëtarë që këndonin „bosançe”, e të cilët në të vërtetë ishin shqiptarë dhe në kohën kur Murkoja bënte hulumtime, ata në disa vise këndonin edhe në gjuhën serbokroate. Ç’është e vërteta, Murkoja nuk bën një dallim të nevojshëm midis këngëtarëve shqiptarë, „myslimanë” dhe atyre „turq”. Ai përdor disa emërtime si „Albanci”, „Arnauti”, „Muslimanski Albanci”, por edhe vetëm „muslimani”. Në bazë të të dhënave rreth traditës që i përkasin dhe prej kujt i kishin mësuar këngët si dhe nga vetë veshja (Murkoja i ka fotografuar shumë këngëtarë prej të cilëve ka shënuar këngët) etj., s’është vështirë të caktohet përkatësia kombëtare e tyre. Kështu, fjala vjen, për këngëtarin Halil Lugonjën, i cili këndonte edhe nga pesë orë për Mujin e Halilin, Murkoja thotë se ishte mysliman (!), por nuk jep të dhëna të tjera. Po kështu këngëtarin Osman Komaricën, nga komuna e Beranit (i cili jetonte në Pejë nga viti 1912) e quan mysliman, edhe pse nga fotografia (f. 38—2) vërehet qartë se ka të veshur tirqit me gajtana dhe jelekun me sumbulla, që janë veshje e shqiptarëve.¹³ Edhe këngëtarin shqiptar, Maxhun Fazlinë, nga Morina e Gjakovës, e quan vetëm „mysliman”, edhe pse edhe nga fotografia që boton¹⁴ shihet qartë se për çfarë „myslimani” është fjala. Kështu ndodh edhe me një numër të konsiderueshëm këngëtarësh të tjerë të Murkos.

Ç’është e vërteta, emërtimet „myslimanë” dhe „turk” për shqiptarët midis dy Luftërave Botërore ishin zyrtarizuar, prandaj Murkoja i përdorte ashtu si i thoshin subjektët dhe përcjellësit zyrtarë. Siç thekson me të drejtë Tihomir Gjorgjeviqi „Meqë (shqiptarët — A. B.) ishin të fesë muhamedane dhe jetonin si turqit, për këtë arsye i kanë quajtur turq...”¹⁵ e po kështu dhe muslimanë, prandaj nga studiues të ndryshëm, por edhe nga persona të tjerë, shpesh herë nuk është bërë dallimi i nevojshëm ndërmjet përcaktimit fetar dhe përkatësisë kombëtare.

Duke treguar mënyrën e punës në terren për gjetjen dhe mbledhjen e këngëve nga këngëtarët. Murkoja thekson dhe vështirë-

¹² *Srpskohrvatske junačke pjesme*, e cit. f. IX.

¹³ M. Murko, *Tragom...*, Knjiga II, f. 641.

¹⁴ *Po aty*, f. 645.

¹⁵ Tihomir Đorđević, *Arbanasi u Srbiji za vlade Kneza Miloša* Në: *Naš narodni život*. Knjiga šesta. Beograd 1932, f. 57.

sitë që i kishin dalë, sidomos me organet dhe me njerëzit e pushtetit, të cilët e përcollën pothuaj gjatë gjithë punës së tij në terren.¹⁶ Prania e tyre shpesh kishte përcaktuar strukturën kombëtare të këngëtarëve nga të cilët Murkoja kishte mbledhur materiale. Po kështu organet e pushtetit shpesh kishin dorë edhe në caktimin e katundeve e viseve të cilat i vizitonte studiuesi çek. Prania e këtyre njerëzve po ashtu ndikonte që disa këngëtarë të mos i japin të dhënat e sakta për prejardhjen dhe përkatësinë e tyre kombëtare; shpesh i bishtnonin takimit me mbledhësin, pastaj i jepnin shënime të pasakta¹⁷ etj. Ka pasur raste që kur Murkoja fillonte t'i pyesë se kush dhe prej nga ishin dhe sa i bënte me dije se duhet të bëjnë incizime, këngëtarët çoheshin dhe shkonin.¹⁸ Ka ngjarë që këngëtari ka qenë shqiptar dhe ka kënduar vetëm shqip, e Murkoja të mos e thotë se ishte i përkatësisë së këtillë nacionale. Kështu ndodhi me këngëtarin nga Bajgora, Isa Ymerin, i cili, siç shkruan Murkoja, „dëshironte të jetë (thirret) Imeroviq”.¹⁹ Po ashtu Murkoja bën me dije se i ka ndodhur që para se të arrinte në qendrën përkatëse komunale, përkatësisht të rrethit, të mësojë nga bashkudhëtarët ose njerëzit me të cilët takoheshin në fshatrat, pranë të cilëve kalonte, kishte me dhjeta këngëtarë, por kur arrinte në komunë ose në bashki të rrethit, organet e shtetit i thonin (meqë ato katunde ishin të banuar me shqiptarë) se aty nuk kishte asnjë këngëtar (sic!). S'do mend se një veprim i këtillë kishte përcaktuar në masë të dukshme punën e Murkos për marrjen e shënimeve të disa këngëtarëve si, fjala vjen, për përkatësinë nacionale e fisnore, cilës traditë i përkitnin, kur kishin filluar të këndojnë dhe në cilën gjuhë, si quheshin prindërit e tyre etj., ashtu siç kishte vepruar, fjala vjen, M. Parryja etj. gjatë bisedave të gjata me këngëtarët.²⁰ Murkoja e pohon edhe vetë se nuk kishte bërë dallim midis epikës gojore myslimane, ordodokse dhe katolike e as të këngëtarëve, prandaj shkruan: „... por jam bindur shpejt se epika myslimane është krejtësisht e njëjtë me atë të krishterë, ortodokse dhe katolike dhe se ndryshojnë, por jo gjithnjë, për tendencën e përmbajtjes, por që të krishterët i dëgjojnë këngët myslimane dhe anasjelltas. Prandaj më nuk kam bërë kurrfarë dallimi midis këngëtarëve, përkatësisht këngëve të tyre (nënvizimi im).²¹

Një qëndrim i këtillë i Murkos, fatkeqësisht, kushtëzoi që çështja rreth përkatësisë nacionale të disa këngëtarëve dhe të

¹⁶ M. Murko, *Tragom...*, f. 22.

¹⁷ *Po aty*, f. 93.

¹⁸ *Po aty*, f. 112.

¹⁹ *Po aty*, f. 108.

²⁰ *Serbo-Croatian Heroic Songs. Collected by Milman Parry. Volume four. Zenidba Smailagina Sina...* e cit. f. 1—54.

²¹ M. Murko, *Tragom...*, f. 12.

traditave të tyre, të mbesin të paqarta dhe të hapura, sidomos kur u bë fjalë për epikën gojore shqipe, përkatësisht për këngëtarët shqiptarë.

3. Rreth epkës gojore shqipe dhe këngëtarëve shqiptarë

Siç theksuam edhe më parë, Murkoja ishte nisur në Jugosllavi për ta hulumtuar dhe për ta bërë objekt trajtimi epikën gojore në gjuhën serbokroate, e sidomos epikën e myslimanëve të Bosnës dhe Hercegovinës. Mirëpo gjatë punës në terren, në disa vise që ai i vizitoi me ndërprerje, duke filluar nga viti 1909 e deri në vitin 1932 (ai ishte tetë herë në Jugosllavi për të bërë hulumtime), mori dhe disa të dhëna për epikën gojore shqiptare, për këngëtarët shqiptarë, incizoi disa materiale, ndërsa në vëllimin e dytë të „Gjurmëve të epikës popullore serbokroate” në „Prilozi” botoi tri këngë shqipe me përkthimin përlesh në gjuhën serbokroate.²²

Qysh në *Raportin*²³ e Akademisë Mbretërore të Shkencave të Vjenës të botuar më 1913, Murkoja jep ndonjë të dhënë që, edhe pse në mënyrë të tërthortë, mund të lidhet me traditën tonë epike. Në të vërtetë, duke bërë fjalë për priftin në pension, Jozo Vukeliqin, nga Drezhniku, bën me dije se ai i kishte dhënë shënime për këngëtarin Ilija Gashleviqin, mullis katolik nga Drezhniku vdekur më 1899, prej të cilit prifti në fjalë kishte mbledhur materiale për Matica Hrvatska. Si pasardhës i këtij këngëtar, po ashtu mullis nga Drezhniku, Matija Murko bën me dije për kroatin Mile Hodakun, i cili i këndon këngët që i kishte mësuar nga I. Gashleviqi. Ky këngëtar, njofton Murkoja, këndonte më me dashuri për trimëritë kundër turqve, kryesisht për Gjergj Kastriotin, Smilaniq Ilinë, Ivo Senjaninin etj.²⁴ Po në këtë Raport Murkoja përmend këngëtarin, Niko Gjeriqin, për të cilin Muharrem Hoshiqi nga Bihaqi thotë se atë nuk e dëgjonte asnjë turk, sepse ai këndonte këngë të tjera dhe për bajraktarë të tjerë. Edhe emrat e burimeve, bjeshkëve, fushave, qyteteve janë të tjera të Niko Gjeriqi e të tjera të na. Murkoja, për fat të keq, nuk jep të dhëna të tjera për këtë këngëtar që ishte bari. Cilat ishin ato burime, bjeshkë, fusha e qytete që i përmend Niko në këngë dhe cilat ishin, në të vërtetë, këngët që i këndonte ai? Çështja tash për tash mbetet e hapur, por nuk është larg mendsh që ky këngëtar,

²² M. Murko, *Tragom...* Knjiga II, f. 896—901.

²³ Mathias Murko, *Bericht über eine Bereisung von Nordwestbosnien und der angrenzenden Gebiete von Kroatien und Dalmatien behufs Erforschung der Volksepik der bosnischen Muhammedaner*. Në: *Sitzungsberichte der Kais. Ak. der Wiss. in Wien. Phil.* — His. Klasse, 173. Band, 3 Abhanlung. Wien 1913, f. 1—52.

²⁴ *Po aty*, f. 8.

si dhe I. Gashleviqi dhe disa të tjerë, t'i përkitnin traditës shqiptare. Një supozim të këfillë e mbështesim në faktin se në Hercegovinë, Bosnë e Dalmaci, shqiptarët janë të pranishëm qysh herët, sipas të dhënave edhe para invadimit osman (të dhëna gjuhësore, onomastike, etnografike etj.) dhe se një traditë e këndimit të këngëtarëve shqiptarë në gjuhën serbokroate ekzistonte më herët. Për këtë kemi disa shembuj tipikë në mbarim të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë.²⁵ Të dhënat e Murkos dhe të disa studiuesve të tjerë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, dëshmojnë për këtë dukuri.

Po në të njëjtën faqe të punimit në shqyrtim, ku bëhet fjalë për këngëtarin Niko Gjeriqin, Murkoja jep dhe dy vargje përfunduese të një kënge të kënduar nga Omer Pehaxhiqi nga Veleçeva e Kluçit: *vako çujem i vami kažem, / A Bog znade, jel tako bilo.*²⁶ Ai që njih sidomos përfundimin e këngëve kreshnike shqiptare dhe strukturën sintaksore të vargjeve përfundimtare, nuk e ka vështirë të hetojë ngjashmërinë e drejtpërdrejtë të këtyre vargjeve me ato në gjuhën shqipe, përkatësisht të fitojë përshtypjen se janë përkthim nga shqipja.

Në Raportin e vitit 1915, ku jepet një pasqyrë e fonografimit të këngëve në Bosnë e Hercegovinë,²⁷ pos tjerash, Murkoja përmend edhe prof. Jamicky-n, me prejardhje nga Kroacia, i cili i ndihmonte atij për sqarimin e fjalëve dhe vargjeve gjatë deshifrimit. Ky profesor i stenografisë në gjimnazin e Mostarit kishte vështirësi gjatë deshifrimit të materialeve. Disa fjalë kryesisht turke nuk i kuptonte, por nuk i kuptonte edhe vargjet e tëra në gjuhën serbokroate.²⁸ Si shpjegohet dukuria që një vendas të mos i kuptonte vargjet në gjuhën serbokroate? Murkoja, mjerisht, nuk jep shënime për këtë dukuri edhe pse ai u ballafaqua disa herë me të, siç i ndodhi në Tuzëll e në disa vende të tjera. Në të vërtetë, këngëtarin, siç e quan Murkoja, mysliman, Sulo Gradaliq nga Tuzlla (gjyshi i tij ishte nga Podgorica e Malit të Zi) askush nuk e kuptonte mirë, madje as drejtori mysliman i gjimnazit e as mësuesi mysliman i mësimin fetar i Tuzllës.²⁹ Po të kishte dhënë shënime më të afërta për babanë e këngëtarit, (nga Podgorica), për farefisën, prej kujt i kishte mësuar këngët etj., atëherë çështja e „moskuptimit” të tij nga vetë myslimanët do të sqarohej. A thua vallë kush mund të ishte ky „južnjak” që ishte vendosur në

²⁵ Shih pos tjerash punimin „Kush ishte Abdullah (Avdo) Megjedoviqi” në këtë vëllim.

²⁶ M. Murko, *Bericht...*, Wien 1913, f. 31.

²⁷ Matthias Murko, *Bericht über phonographische Aufnahmen epischer Volklieder im mittleren Bosnien und in der Herzegovina im Sommer 1913*. Në: Sitzungsberichte der Kais. Ak. der Wiss. in Wien. Phil. — Hist. Klasse. 179. Band, 1. Abhandlung. Wien 1915, f. 1—23.

²⁸ M. Murko, *po aty*, f. 11.

²⁹ M. Murko, *Tragom...* f. 109. Shih dhe f. 392.

Tuzëll dhe e kultivonte këngën kaq shumë? Është afër mendsh se mund t'i përkiste traditës shqiptare të këndimit, dhe për këtë arsye nuk kuptohej nga myslimanët. Ngulitja e babait të tij (nga Podgorica ku kishte mjaft shqiptarë) në Tuzëll, jep mundësi të supozohet për traditën që i përkiste ky këngëtar. Tek e fundit, Murkoja nuk e njihte, madje as nuk i interesonte gjithaqë, historia e popujve të Ballkanit e më se paku ajo e shqiptarëve, prandaj nuk është e çuditshme që të thotë se edhe Balshajt ishin mbretër bosanë.³⁰

Nga të dhënat që kishte marrë në terren për shqiptarët,³¹ nga kontaktet me këngëtarët shqiptarë dhe me disa „myslimanë”, nga këngët që kishte mbledhur — incizuar dhe nga ajo që kishte përjetuar në disa mese të banuara me shqiptarë, Murkoja kishte fituar një pasqyrë sado modeste, për traditën e këndimit të shqiptarët dhe për kultin e tyre ndaj këngës në ato vise nëpër të cilat kaloi.

Nisur kryesisht nga përvoja që fitoi në terren, Murkoja thekson se të shqiptarët është ruajtur mirë tradita e këndimit dhe se tek ata përherë krijohen dhe lindin këngë të reja.³² Thua se nuk ka ndonjë ngjarje me rëndësi për jetën e tyre që ata të mos e qesin në këngë. Sipas një pohimi të një kapteri nga Timoku, shqiptarët madje këndojnë edhe për ndonjë „marri” që e bën ndonjëri prej tyre.³³ Edhe pse ky pohim i kapterit si dhe ai i panduarit³⁴ (xhandar në Serbinë e vjetër) shfaqet më tepër si mendim ekstrem (ndoshta ndonjë ngjarje që këndohej për ta ishte marri, por për botëkuptimin dhe traditën shqiptare, gjë e natyrshme dhe e nevojshme) ai dëshmon se kënga të shqiptarët ishte një kult i vërtetë dhe se bënte një jetë të gjallë. Për këtë kishin nāikuar kushte e rrethana të ndryshme, pastaj trashëgimia e këndimit nga e kaluara, e jetesës si dhe, siç shkruan Murkoja, kultura shpirtërore, shoqërore dhe materiale, nga e cila shumë dukuri janë ruajtur në traditën epike.³⁵

Të dhënat e Murkos lidhen sidomos me epikën gojore shqiptare. Ai thekson se shqiptarët e kanë këngën epike të zhvilluar, sidomos në Kosovë, në Metohi, në kufirin malazezo-shqiptar etj.³⁶ Këngët e këtilla shqiptarët i quajnë *Kānga*, *Kōnga*, ndërsa atë që e këndon *kongetor*. Murkoja thekson se shqiptarët këndojnë me lahutë, në dhjetërrokësh ose, shumë rrallë, në dymbëdhjetërro-

³⁰ *Po aty*, f. 452.

³¹ *Po aty*, f. 93, 112 dhe 70 (kur këngët i këndojnë tinëz).

³² Shih moton në fillim të punimit. M. Murko, *Tragom...*, f. 40.

³³ *Po aty*, f. 40.

³⁴ *Po aty*, f. 514.

³⁵ *Po aty*, f. 448.

³⁶ *Po aty*, f. 272.

kësh.³⁷ Krahas lahutës përdoret edhe çiftelia. Këngëtari epik quhet, sipas lahutës, *lautar*. Shqiptarët, thekson Murkoja, këndojnë për ardhjen e turqve në Ballkan. Po ashtu e kanë ruajtur *traditën kosovare kryesisht për Millosh Obiliqin*. Në mënyrë të veçantë këndojnë për çiftin vëllazëror, Mujin e Halilin. Rreth kësaj Murkoja shkruan: „... por mes tyre (këngëve — A. B.) më së shumti janë të përhapura këngët kreshnike për Mujin dhe Halilin”.³⁸

Duke bërë fjalë për traditën epike të shqiptarët ky studiues çek thekson se të ky popull, sikur edhe të malazeztë, vazhdohet tradita e këndimit për kaçakët. Kështu ai përmend se në Vuçitërnë kishte dëgjuar këngën e Hasimes, së cilës ia vrasin vëllanë, e ajo më vonë hakmerret. Në Rahovec ia këndojnë këngën për kaçakun, Dan Retinë. Në Kolashin i kishin treguar për Azem Bejtën dhe traditën e këngëtimit për të, ndërsa në Rrafshin e Dukagjinit kishte mësuar për këngën që ka për objekt ndërmarrjen e Mark Milanit për bashkimin e Plavës dhe Gucisë Malit të Zi,³⁹ por edhe për këngët kushtuar Kral Pjetrit, për vrasjen e Frane Ferdinandit, për luftërat e Ballkanit dhe për Luftën Botërore⁴⁰ etj.

Siç theksuam edhe më parë, Murkoja përmend disa këngëtarë shqiptarë dhe jep dhe pak shënime për ta. Në Guci, fjala vjen, ai takon dy këngëtarë: Mazo Kastratin nga Zabeli, të cilin e quan mysliman (!) dhe Nikollë Nikeç (Lexo: Nikçi) Doda nga fisi Nikaj, arnaut katolik (kështu e çuan Murkoja). Ky i fundit dinte 20 këngë, të cilat i kishte mësuar nga xaxhai dhe nga këngëtarë të tjerë. Nga ky këngëtar Murkoja fonografoi këngën „Kraleviq Marku dhe Musa Kesexhia”.⁴¹ Për këngëtarin Smail Zoraiqin, mullis nga Kladnica, thotë se ishte veshur shqiptarçe, s'dinte shkrim lexim, ndërsa këngët i kishte mësuar prej babës dhe gjyshit dhe njerëzve të tjerë, emrat e të cilëve nuk ua përmend. Këndonte vetëm këngë kreshnike.⁴² Si këngëtar të mirë të këngëve kreshnike (këndonte për Mujin e Halilin nga pesë orë) ai përmend dhe Halil Lugonjanin⁴³ pastaj Magjun Fazlinë nga Morina e Gjakovës, i cili këndonte këngë të gjata.^{43a} Disa këngë Murkoja i fonografoi prej Isa Imerit nga Shala e Bajgorës, kurse variantet e botuara nga ky këngëtar në *Shtojcën* e librit të dytë i mbledhi Vojislav Dançetoviqi, albanolog nga Beogradi.⁴⁴

³⁷ *Po aty*, f. 273.

³⁸ *Po aty*, f. 273.

³⁹ *Po aty*, f. 273.

⁴⁰ *Po aty*, f. 274.

⁴¹ *Po aty*, f. 143.

⁴² *Po aty*, f. 88.

⁴³ *Po aty*, f. 99.

^{43a} *Po aty*, f. 102.

⁴⁴ M. Murko, *Tragom...* Knjiga II, f. 895—899.

Për Osman Komaricën Murkoja thekson se ishte nga Eerani, por nga viti 1912 punonte dhe jetonte në Pejë. Ka filluar të këndojë nga mosha njëzetvjeçare. Në fëmijëri i ka dëgjuar këngët nga këngëtari i verbër Qorr Huseni (Husa). Ka kënduar këngë kreshnike. Murkoja i thotë mysliman,⁴⁵ ndërsa sipas fotografisë së bërë nga Murkoja dhe të botuar shihet qartë se është i veshur sipas traditës shqiptare (tirqit me gajtanë, jeleku me sumbulla etj.).⁴⁶ Osmani ishte ndër ata këngëtarë që ishte i kujdesshëm për zgjedhjen e këngëve kur, fjala vjen, këndonte para myslimanëve dhe para ortodoksëve,⁴⁷ pra i përshtatej publikut. Ky këngëtar ishte nxënës i këngëtarit me famë, Qorr Husës, për të cilin thotë se nuk kishte qenë i verbër nga lindja.⁴⁸

Murkoja flet dhe për këngëtarin Sali Uglaninin (nga i cili më vonë studiuesi amerikan, Milman Parry mblodhi dhe botoi mijëra vargje)⁴⁹ nga Ugli i Peshterit. Studiuesi çek thotë se ai jetonte ku „jetonin shqiptarët”, por është „boshnjak i vërtetë”. Në vitin 1930, sipas Murkos, Salihu i kishte rreth 63 vjet. Mësues i tij ishte Qorr Huseni nga Kollashini i Malit të Zi (njëri ndër këngëtarët e verbër më të njohur në gjithë Sanxhakun dhe më gjerë). Pos në Ugël e në Novi-Pazar, ai qëndroi një kohë dhe në Bosnë. Murkoja nuk thotë se Salihu ishte shqiptar, edhe pse ai ishte i tillë. Në të vërtetë, sipas të dhënave të studiuesit amerikan, M. Parrysë, Salihu ishte shqiptar, nënën e babanë i kishte shqiptarë dhe se në gjuhën shqipe kishte kënduar deri në moshën tridhjetëvjeçare.⁵⁰ Murkoja përmend faktin se „Sali Peshterci” (sikur e quanin) është interesant nga se u ka kënduar shqiptarëve nga Kosova dhe Peja këngë kreshnike të kthyera në shqip (sic!) me zë tjetër dhe me tjetër lahutë.⁵¹ Nga ky këngëtar Murkoja fonografoi në gjuhën shqipe dhe bosançe këngën „Doiçin kapetani nga Sinji grabit gruan e Mujit”. S’do mend se përkatësia nacionale e Sali Uglaninit dhe këndimi i tij në gjuhën shqipe dhe bosançe ndikoi që Murkoja të mos shënojë këngë prej tij. Mirëpo dy-tre vjet më vonë, prej këtij këngëtar i mblodhën dhe më vonë u botuan rreth 15.000 vargje.⁵² Disa të dhëna për këtë këngëtar i shënoi Alois

⁴⁵ M. Murko, *Tragom...* Knjiga I, f. 101.

⁴⁶ M. Murko, *Tragom...* Knjiga II, f. 641. Foto nr. 38—2.

⁴⁷ M. Murko, *Tragom...*, Knjiga I, f. 371.

⁴⁸ *Po aty*, f. 94.

⁴⁹ *Srpskohrvatske junačke pjesme*. Knjiga II... e cit. Beograd Kembridž 1953.

⁵⁰ *Po aty*, f. 2.

⁵¹ M. Murko, *Tragom...*, f. 94. Profesori Wollman, duke bërë fjalë për ngjashmërinë e këndimit të myslimanët dhe të shqiptarët, thotë ndër të tjera se kishin „të njëjtin zë, të njëjtën melodi”. M. Murko, *Tragom...*, f. 94.

⁵² *Srpskohrvatske junačke pjesme*, e cit. f. 8—184.

Shmaus (Aloiz Shmaus) më 1937 dhe i botoi më 1938.⁵³ Edhe Murkoja edhe Shmausi i bishtnojnë faktit se Salih Uglanini ishte shqiptar dhe se ishte formuar si këngëtar në traditën shqiptare dhe se këndimin në gjuhën serbokroate e kishte filluar në moshën 35-vjeçare.⁵⁴

Duke bërë fjalë për dukuri të ndryshme të epikës në gjuhën serbokroate, për tematikën dhe për disa çështje të tjera të ekzistimit dhe të funksionimit të saj, por edhe për epikën gojore shqipe, Murkoja përmend edhe këngët kushtuar trimit shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Qysh në punimin e vitit 1913 për epikën popullore të muhamedanëve (term i Murkos) të Bosnës,⁵⁵ ai thekson se Mile Hodaku (i cili këngët i kishte mësuar nga Ilia Gashleviqi) këndonte sidomos për Gjergj Kastriotin dhe për trima të tjerë.⁵⁶ Në Konjicë një myslimin (term i Murkos) ia këndon një këngë për Gjergj Kastriotin, për të cilën Murko supozon se mund të jetë e ndikuar nga Kaçiçi.⁵⁷ Edhe në veprën „Gjurmëve...” ai bën fjalë disa herë për ekzistimin e traditës së këndimit për kryetrimin shqiptar, Skëndebeun. Profesori çek përmend Kaçiçin⁵⁸ dhe tetë këngët kushtuar Skënderbeut si dhe një këngë të Draganovit, i cili më 1894, brenda këngëve nga Maqedonia, botoi dhe një këngë kushtuar Skënderbeut.⁵⁹ (Një këngë për Skënderbeun e botuan qysh më 1866 edhe vëllezërit Milladinov).⁶⁰ Duke bërë me dije për këshillat e tij studentëve që të bëjnë objekt trajtimi një personalitet historik në këngët popullore, Murkoja përmend Quodvult-deus Matijen, i cili po përgatitte shqyrtimin për praninë e Skënderbeut në epikën jugosllave, prandaj gjatë udhëtimit në vitin 1939 në Bosnë, Dalmaci dhe Serbi, nga goja e lahutarëve mbledhi këngë të reja për Skënderbeun.⁶¹ Gjatë shqyrtimit të ribotimit të këngëve nga përmbledhjet e mëparshme, Murkoja thekson se ndër

⁵³ A. Šmaus, *Nekoliko podataka o epskom pevanju i pesama Arbanasa (Arnauta) u Staroj Srbiji* (Einiges zur Volksepik der Albaner in Altserbien). Në: *Prilozi proćavanju narodne poezije*. Knjiga I, sv. 1—2, Beograd 1934, f. 107—112; Alois Schmaus, *Gesammelte slavistische und balkanologische Abhandlungen IV*. (in serbokroatische Sprache). Dr. R. Trofenik. München 1979, f. 58.

⁵⁴ Si fusnota nr. 50.

⁵⁵ M. Murko, *Bericht...*, e cit. Wien 1913, f. 8.

⁵⁶ *Po aty*, f. 8.

⁵⁷ M. Murko, *Bericht über eine Reise zum Studium der Volksepik in Bosnien und Herzegowina im Jahre 1913*. Në: *Sitzungsberichte der Kais. Ak. der Wiss. in Wien. Phil. — His. Klasse*. 176. Band, 2. Abhandlung Wien 1915, f. 30.

⁵⁸ Andrija Kačić Miošić, *Razgovor ugodni naroda slovinskoga*. (1756 dhe 1759). Në këtë vepër tetë këngë i kushtohen Skënderbeut.

⁵⁹ M. Murko, *Tragom...*, f. 252.

⁶⁰ Konstatin Miladinov, *Zbornik narodnih makedonskih pesama*. Zagreb 1861. Këtu botohet dhe një këngë për Skënderbeun.

⁶¹ M. Murko, *Tragom...*, f. 282.

trimat e tjerë të epikës në gjuhën serbokroate, këndohet dhe për kryetrimin shqiptar Gjergj Kastriotin Skënderbeun, të cilat (këngë) Murkoja i konsideron me prejardhje nga Kaçiçi, edhe pse këngëtarët — siç shkruan ai vetë — „*dëshmonin se këngët e veta (kushtuar Skënderbeut — A. B.) i kishin dëgjuar prej këngëtarëve të tjerë. (nënvizimi im)*”.⁶²

4. Rreth traditës së këndimit në dy gjuhë dhe rreth këngëtarit të verbër — Qorr Husenit

Gjatë punës në terren Murkoja u gjet para një dukurie që, as e kishte dëgjuar më parë, as e bëri objekt trajtimi për ta ndriçuar në masën e duhur — këndimin në dy gjuhët. Ç’është e vërteta, në Novi-Pazar ai takoi disa këngëtarë që këndonin shqip dhe bosançe, përkatësisht shqip dhe serbokroatisht. Ndër të tjerë përmendet Sali Uglaninin dhe Resho Alihaxhiqin. Për këtë dukuri na bëjnë me dije edhe M. Parryja,⁶³ Albert Lordi,⁶⁴ Alois Schmausi⁶⁵ etj.

Për Resho Alihaxhiqin, Murkoja vetëm përmend se këndonte në të dy gjuhët. Ishte nga katundi Gujiq, rrethi i Sjenicës. Kishte 67 vjet dhe ishte analfabet. Filloi të këndoje qysh kur kishte dhjetë vjeç.⁶⁶ Nga fotografia e tij (në shoqëri me Rashid Azotiçin me veshje shqiptare)⁶⁷ dhe nga fakti se këndonte edhe shqip, sikur edhe Salih Uglanini, mund të përfundohet se ai i përkiste traditës shqiptare dhe se me kohë, sikur Salih Uglanini, Avdo Megjedoviçiq etj. kishte filluar të këndoje edhe bosançe.

Nga të dhënat që jep Murkoja për Osman Komaricën dhe nga rrethi ku jeton dhe vepron ai (në Pejë nga viti 1912) edhe ky duhet të ketë kënduar në të dy gjuhët. Bahtulla Staviçki (musliman nga Rahoveci) ia këndon Murkos, pos tjerash, këngën për Dan Retinë dhe Kraleviq Marku dhe Musa Kesexhia.⁶⁸ Profesori çek nuk thotë se në cilën gjuhë këndonte ky këngëtar. Atij i mjafton të thotë se këngëtarin ishte mysliman.

Për këngëtarin Marko Gjokiçin, nga Damaneku i Podrimjes, shkruan se këndonte pa lahutë në gjuhën serbokroate, shqipe dhe turke.⁶⁹ Murkoja jep edhe një të dhënë interesante. Ai thotë se në

⁶² *Po aty*, f. 284.

⁶³ *Srpskohrvatske junačke pjesme*, e cit., Beograd — Kembridž, 1953, f. XXXI.

⁶⁴ Albert Bates Lord, *Nasleđe Milmana Parryja*. Në: *Latina et Greca*, Zagreb 1985, br. 26, f. 15.

⁶⁵ A. Smaus, *Nekoliko podataka...*, pun. cit. f. 11.

⁶⁶ M. Murko, *Tragom...*, f. 96.

⁶⁷ M. Murko, *Tragom...*, Knjiga II, f. 626.

⁶⁸ M. Murko, *Tragom...*, f. 103.

⁶⁹ *Po aty*, f. 104.

Kurshumli Radenko Stefanoviçiqi (120 vjeçar) i thotë se dikur *turqit kanë kënduar shqip dhe turqisht*.⁷⁰ S'do mend se turqit, si robërues, nuk e mësonin gjuhën e atyre që i nënshtronin, por ndodhte e kundërta. Pra „turqit” e plakut nga Krushumlia ishin në të vërtetë shqiptarë që këndonin shqip dhe turqisht. Në të mirë të këtij mendimi dëshmojnë edhe të dhënat e tjera të autorëve të mëhershëm, por edhe të Murkos e të studiuesve të tjerë të mëvonshëm. Si dëshmi e kësaj po përmendim të dhënën e R. Medicës, i cili konstaton se në Tivar të Malit të Zi turqit (në katundet e tyre) këndojnë shqip, turqisht dhe serbisht.⁷¹ Nuk do mend se këta „turq” të katundeve të rrethit të Tivarit ishin shqiptarë dhe se quheshin të tillë, pra „turq”, nga se një qëndrim i tillë ishte i lidhur ngushtë me politikën zyrtare, e cila, sidomos për shqiptarët, kishte karakter mohues dhe çkombtarizues.

Për këndimin e këngëtarëve shqiptarë në gjuhën serbokroate kemi të dhëna qysh më 1837 në vëllimin e botuar të S. Millutinoviçiqit,⁷² ndërsa për këndimin e shqiptarëve në gjuhën greke më 1846. Gjuhëtari i famshëm italian, B. Biondelli, shkruan se luftëtarët shqiptarë këndonin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke.⁷³ Të dhëna të ngjashme sjellin edhe autorët si Mark Milani, M. Parryja, A. Lordi, etj.

Një problem i rëndësishëm që del nga vepra e M. Murkos është ai rreth këngëtarëve të verbër, përkatësisht rreth këngëtarit nga Kollashini, Qorr Husenit (Huso ose Husoviçiq), i cili konsiderohet me të drejtë njëri ndër këngëtarët më të famshëm të shekullit të kaluar dhe të shekullit tonë. Murkoja nuk jep shumë të dhëna, por ato bëhen të rëndësishme kur vështrohen në tërësinë e shënimeve që japin M. Parryja, A. Lordi, A. Shmausi etj. dhe kur gjithë problemi rreth këtij këngëtarit trajtohet brenda traditës së epikës gojore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate në trevën ku jetoi dhe veproi Qorr Huseni.

Për Qorr Husenin, për të cilin njëri ndër këngëtarët më të mirë të M. Parrysë, Sali Uglanini, thoshte se „Nuk mund të kishte (këngëtar — A. B.) mbi të”⁷⁴ Murkoja shkruan se ishte mysliman, ndërsa A. Shmausi e quan „turk”. Për përkatësinë nacionale të këtij këngëtarit nuk jepen të dhëna të mjaftueshme. Siç theksuam, ai cilësohet si „mysliman” ose „turk” edhe pse disa këngëtarë

⁷⁰ *Po aty*, f. 274.

⁷¹ *Po aty*, f. 274.

⁷² *Pevanija crnogorska i hercegovačka*. Sabrana Cubrom Čajkovičem cernogorcem. U Laipçigu, 1837. Mbledhësi i këngëve të botuara në këtë vëllim është Sima Milutinoviçiqi.

⁷³ B. Biondelli, *Geschichte, Sprache und Poesie der Albanesen*. Në: *Magazin für die Literatur des Auslandes*. Nr. 133. Berlin den 5 November 1846, f. 531. Shih dhe B. Biondelli, *Studii Linguistici*, Milano 1856, f. 85.

⁷⁴ *Srpskohrvatske junačke pjesme...*, e cit. f. 3.

shqiptarë, që këndojnë edhe në gjuhën serbokroate, i mësojnë këngët prej tij. Këtë këngëtar e krahasuan me Homerin e verbër. Studiuesi amerikan, M. Parryja, edhe studimin e vet të papërfunduar e quajti „Qorr Huso, studimi mbi këngën epike jugosllave”,⁷⁵ ku synoi të dëshmojë karakterin letrar gojor të dy kryeepave antike, „Iliadës” dhe „Odisesë” dhe mundësinë e ekzistimit të Homerit si poet i verbër që i kishte kënduar këto dy epe. Qorr Huseni krahasohet me Homerin, jo pse nga ai u mblodh material konkret, por pse ai, në bazë të të dhënave që japin pasardhësit këngëtarë, kishte qenë njëri ndër këngëtarët më të njohur të traditës epike në Sanxhak dhe më gjerë dhe kishte lënë gjurmë të mëdha në zhvillimin e epikës gojore. Për këtë dëshmojnë disa këngëtarë, të cilët kishin mësuar me dhjetra këngë prej Qorr Husenit si, fjala vjen, Sali Uglanini, Osman Komarica etj., që merren si vazhdues të drejtpërdrejtë të traditës së epikës gojore që i përkiste Qorr Huseni.

Kush mund të ishte ky këngëtar i verbër i klasit të parë?

Në vitin 1937, kur viziton Sanxhakun, A. Shmausi mori disa të dhëna për këtë këngëtar.⁷⁶ Ato ia dhanë Sali Uglanini, nga Ugli (më 1937 jetonte në Novi-Pazar), Halit Hamzagiqi nga Tutini dhe Salko Hoti nga Veleg Pola (Tutin). Pra për Qorr Husenin i dhanë shënimet shqiptarët myslimanë, edhe pse këtë gjë Shmausi nuk e thotë! Çështje e vërteta, Shmausi as për Sali Uglanini, fjala vjen, nuk thotë se ishte shqiptar, por e cilësonte vetëm „mysliman” dhe sikur M. Parryja të mos kishte dhënë shënime të plota për rrugën dhe përkatësinë nacionale të këtij këngëtar i dhe të disa të tjerëve, asnjëherë nuk do të mund të sqaroheshin përkatësia e tyre nacionale dhe ata do të mbetnin në histori si „mysliman” ose si „turq” sikur ishte bërë zakon të quheshin shqiptarët midis dy luftërave botërore.

Ky këngëtar, siç e cilëson Murkoja Qorr Hysenin: „na bën të sjellim në mend këngëtarët më të mirë të kohës feudale”⁷⁷ këndonte nëpër vende të ndryshme, sidomos nëpër katunde, kishte qenë edhe në Bosnë (sipas Salko Hotit) madje edhe në Vjenë, ku kishte kënduar për Franjë Josipin (sipas Murkos dhe Shmausit). Ndodhte që në një katund të qëndrojnë me muaj. E ftonin beglerë dhe agallarë dhe e mbanin me ditë të tëra në shtëpitë e tyre. Ishte i shtresës së pasur dhe këndonte vetëm për qejf. Kurrë nuk ka shkuar të lypë prej shtëpie në shtëpi.⁷⁸ *Ka ditur këngë aq sa ka pasur ditë viti.*⁷⁹

⁷⁵ *Po aty*, f. XV.

⁷⁶ A. Šmaus, *Čor Huso Husović*. Në: PPNP, 5, Beograd 1938, f. 267—269. Edhe A. Schmaus, *Gesammelte slv. und balk. Abhandlungen*, e cit. f. 39—44.

⁷⁷ M. Murko, *Tragom...*, f. 212.

⁷⁸ *Po aty*, f. 213.

⁷⁹ *Po aty*, f. 213.

Sipas të dhënave që Sali Uglanini ia jep studiuesit amerikan, M. Parrysë, Qorr Huseni kishte kënduar në katundin e Salihut, në Ugël. Në këtë katund, siç i pohon Salihu studiuesit, M. Parrysë, jetonin vetëm shqiptarë.⁸⁰ Pra prej 70 shtëpive, sa ishin në katund, të gjithë ishin shqiptarë. Në Ugël Qorr Huseni, sipas Shmausit, kishte qëndruar 3—4 ditë,⁸¹ ndërsa sipas asaj që thotë Sali Uglanini, edhe një muaj.⁸² Në ç'gjuhë vallë do t'u ketë kënduar shqiptarëve Qorr Huseni? Po në Tutin, ku po ashtu banonin shqiptarë, në ç'gjuhë do të ketë kënduar Qorr Huseni? Në qoftë së gjithë kësaj ia shtojmë faktin se Shmausit dhe M. Parrysë, Lordit etj. të dhënat kryesore për këtë këngëtar ia japin këngëtarët shqiptarë, si dhe faktin se këngëtarët, të cilët kishin mësuar këngë prej Qorr Husenit ishin shqiptarë dhe se me kohë kishin filluar të këndojnë edhe në gjuhën „bosançe”, atëherë sipas një logjike të zakonshme mund të sjellim përfundimin se Qorr Huseni do të ketë kënduar shqip dhe, duke pasur parasysh dukuritë e këndimit në të dy gjuhët, ai këndoi edhe në gjuhën serbokroate, ashtu siç ndodhi me nxënësit e tij dhe me Abdulla (Avdo) Megjedoviçin, këngëtarin më të mirë të M. Parrysë, i cili gjuhë të nënës e kishte shqipen. Edhe këngëtari Halil Mehmetaj i Trubuhocit të Istogut, nga i cili në nëntor — dhjetor (1986) incizua tetë këngë kreshnike,⁸³ thotë se ka dëgjuar për Qorr Husen e Kollashinit. Meqenëse Halil Mehmetaj nuk e di gjuhën serbokroate, atëherë vëshirë që ai të mbante mend e të dinte për një këngëtar që i përkiste traditës epike jo shqiptare. Me anën tjetër, emri Qorr Hyseni të shqiptarët si dhe në traditën epike shqipe është mjaft i përhapur. Në Shalë të Bajgorës (më 1954) nga një këngëtar i verbër, Qorri i Bajgorës, mblodhi disa këngë kreshnike Anton Çetta,⁸⁴ ndërsa ekziston edhe kënga e njohur shqipe me titull „Qorr Ilazi”.⁸⁵ Edhe shënimi i M. Murkos se Qorr Huseni këndonte këngë që bëjnë fjalë për luftërat e „turqve të Kollashinit kundër malazezve”⁸⁶ flet në të mirë të mendimit që theksuam, sepse „turqit” e Kollashinit ishin në të vërtetë shqiptarët që këndojnë për luftërat e tyre me malazezët në shekullin e kaluar. Në të mirë të kësaj dëshmojnë shumë të dhëna historike.

⁸⁰ *Srpskohrvatske junačke pjesme*, e cit. f. 1.

⁸¹ A. Smaus, *Čor Huso Husović*, i cit. në *Gesammelte slav. u beik. Abhandlungen*, f. 42.

⁸² Shih punimin „Kush ishte Abdullah (Avdo) Megjedoviç?”

⁸³ Të dhënat gjenden në Arkivin e Institutit Albanologjik të Prishtinës në dosjen e A. Berishës nga viti 1986-të.

⁸⁴ Anton Çetta, *Kërkime folklorike*, Rilindja, Prishtinë 1981, f. 222—226.

⁸⁵ *Këngë popullore shqiptare të Kosovë-Metohisë*, bleni II, mbarështrur prej V. Dançetoviç, A. Çetta dhe Kadri Halimi, Prishtinë 1953, f. 203.

⁸⁶ M. Murko, *Tragom...*, f. 213.

Pa dyshim se në Koleksionin e Milman Parrysë, në Harvard University, gjenden të dhëna më të plota edhe për Qorr Husenin (Koleksioni i M. Parrysë, pos materialeve të tjera, përmban dhe rreth 13.000 tekste të mbledhura nga vetë ky studiues), ashtu sikur për Sali Uglaninin, Gjemajl Zogiqin, Sulejman Makiqin, Alia Fjulaninin, Abdulla (Avdo) Megjedoviqin e shumë të tjerë.

5. Të dhëna për lahutën dhe çiftelinë dhe për përkime poetike

Në punimet e veta dhe në veprën „Gjurmëve të epikës popullore serbokroate” Murkoja jep dhe disa të dhëna për instrumentet të shqiptarët dhe për përkimet e epikës gojore shqiptare me epikën gojore në gjuhën serbokroate dhe më gjerë.

Duke bërë fjalë për poezinë gojore shqipe dhe për traditën e saj, Murkoja thekson se shqiptarët gjatë këndimit, pos tjerash, përdorin lahutën, çiftelinë, sharkinë dhe kavallin. Me lahutë shqiptarët këndojnë sidomos këngët për Mujin dhe Halilin,⁸⁷ ndërsa me çifteli këngët më të shkurtra, me karakter baladik të tipit të Dan Palloshkës.⁸⁸ Mirëpo në disa pjesë të Dukagjinit dhe të Kosovës shqiptarët përdorin dhe sharkinë me katër e gjashtë tela, ndërsa në Rahovec, Murkoja dëgjon këngë duke kënduar edhe me karadyzen.⁸⁹ Ky studiues konsideron se çiftelinë në Ballkan e kanë sjellë turqit.⁹⁰

Brenda problematikës së instrumenteve, me të cilat përcilleshin këngët, Murkoja jep dhe një të dhënë me interes për lahutën. Në të vërtetë, ky profesor çek thekson se në Kosovë kishte mësuar se organet e pushtetit turk i kishin ndaluar lahutat, prandaj këngëtarët i kishim fshehur, dhe ato i kishin dëmtuar minjtë e lagështira⁹¹ dhe se lahutat në Kosovë nuk i përgjigjeshin tipeve të lahutës se Vynshit (Wünsch).

Herë-herë Murkoja dha edhe ndonjë të dhënë ose mendim për përkimet tematike e motivore të epikës gojore në gjuhën serbokroate dhe asaj shqiptare, edhe pse këto mendime nuk janë rrjedhojë e studimit vetjak dhe e njohjes së thellë dhe të gjithanshme të dy epikave dhe të traditës epike të popujve të Ballkanit, përkatësisht e një shqyrtimi objektiv dhe shkencor të bërë nga vetë Murkoja. Ky studiues çek më tepër mbështetet në disa mendime të tjerëve dhe në përshtypjet e rastit që i fiton në bazë të elementeve të dorës së dytë. Kështu, duke bërë fjalë për faktin se në Mal të Zi këngët veçoheshin me karakteristika regjionale dhe

⁸⁷ *Po aty*, f. 338.

⁸⁸ *Po aty*, f. 337.

⁸⁹ *Po aty*, f. 337.

⁹⁰ *Po aty*, f. 338.

⁹¹ *Po aty*, f. 326.

fisnore, Murkoja përmend të dhënën e Mark Milanit se çdo fis kishte këngë dhe tregime të veta, siç ndodhte me fisin e Kuçit,⁹² një e pesta e të cilëve ishin shqiptarë të besimit katolik. Fiset shqiptare, sipas asaj që thuhet në veprën e Murkos, i kishin mbajtur lidhjet me fiset malazeze, prandaj shqiptarët kanë mundur t'i marrin prej tyre shumë këngë.⁹³

Një mendim të këtillë ai do ta theksojë edhe kur bën fjalë për këngët kreshnike shqiptare kushtuar Mujit e Halilit dhe kur përmend mendimin e B. Kopitarit se „Këngët greke të Fauriel-it janë kënduar prej shqiptarëve dhe burimin e kanë në këngët serbe”.⁹⁴ Edhe në pjesën „Historia kulturore e këngëve popullore” Murkoja thekson se lidhjet e ngushta ndërmjet fiseve shqiptare dhe atyre malazeze „shpjegojnë përhapjen e madhe të këngëve epike serbokroate në Shqipëri”.⁹⁵

S'do mend se Murkoja nuk thellohet në problemin e ngjashmërive të epikave gojore në Ballkan dhe më gjerë e as midis epikës gojore shqipe dhe epikës në gjuhën serbokroate. Mendimet e tij në esencë mbesin vetëm pohime. Është për t'u çuditur se si Murkoja nuk u thellua aspak në faktin se populli shqiptar është bartës dhe kultivues i një kulture të lashtë, njëri ndër popujt më të lashtë të Siujdhesës Ballkanike, i cili në mënyrë më të plotë dhe unike po ruante dhe ruajti një trashëgimi të pasur, jo vetëm në fushën e këndimit epik, por edhe atë lirik, në etnografi dhe në fusha të tjera. Edhe vetë Murkoja përmend faktin se fisin e Kuçit një pjesë e përbënin shqiptarët, ndërsa për Palbardhajt dhe Vasojet shkruan: „Bjelopaviqët dhe Vasojeviqët e nxjerrin prejardhjen e tyre prej Dukagjinit shqiptar, prandaj është e kuptueshme ngjashmëria e madhe në këngë, në karakter dhe në jetë”.⁹⁶ Si ishte e mundur që këto dy fise, pastaj fisi i Kuçit dhe disa fise të tjera shqiptare, që me kohë ishin sllavizuar, të ndikinin në përhapjen e këngëve në gjuhën serbokroate në Shqipëri e të mos flitej më parë për ndikimin që këto fise shqiptare, para dhe gjatë asimilimit, të kenë bërë në fiset dhe kulturat e tjera të popujve

⁹² *Po aty*, f. 45.

⁹³ *Po aty*, f. 45.

⁹⁴ *Po aty*, f. 273. Dh. Shuteriqi sjell një mendim tjetër të B. Kopitarit. Në një letër dërguar Xhon Brauring-ut (John Browning), përkthyes anglez i këngëve popullore serbe, Kopitari i shkruante: „S'ka dyshim se këngët greke të botuara prej Faurielit (Fauriel) janë imituar prej shqiptarëve! Mbetet që të bëjmë krahasimin ndërmjet këngëve popullore shqiptare, greke, bullgare e serbe. Cili prej këtyre katër popujve i shpiku?” (Dh. Shuteriqi, *Autorë dhe tekste*. Tiranë 1977, f. 40. Po si ishte e mundur që këngët greke (sic!) të kënduara e të imituara nga shqiptarët të ishin të burimit sllav (!) Për studiuesit e mirëfilltë dhe njohësit e epikës gojore të Ballkanit dhe më gjerë, një formë e këtillë e vlerësimit është e paprueshme.

⁹⁵ M. Murko, *Tragom...*, f. 482.

⁹⁶ *Po aty*, f. 481—482.

me të cilët jetonin në fqinjësi, pra edhe në përhapjen e këngës shqipe ndër malazez, bosanë, hercegovas, kroatë, serbë etj. Meqenëse shkenca tashmë e ka dëshmuar prejardhjen shqiptare të fiseve të përmendura dhe sllavizimin e tyre gradual që nga shek. XV,⁹⁷ atëherë pohimi i Murkos dhe i autorëve të tjerë, ithtarë të mendimit të përhapjes së këngëve në gjuhën serbokroate ndër shqiptarë është i paqëndrueshëm. A ishte e mundur që me sllavizimin e disa fiseve shqiptare të ishte sllavizuar e ndryshuar çdo gjë që shqiptarët e kishin trashëguar dhe i kishte karkterizuar ata shekuj me radhë? Ajo që shkencëtarët e ndryshëm kanë hetuar në ruajtjen e trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të këto fise, por edhe në llojet e letërsisë gojore, pra edhe në vetë këngët dhe përkimet e thella temtiko-motivore dhe gjuhësore-sintaksore, është dëshmi e mjaftueshme se tradita e këndimit të shqiptarët që zunë e u sllavizuan me kohë nuk mund të shuhej e të zhdukej aq shpejt.⁹⁸ Për këtë mund të dëshmojnë dhe disa këngë nga përmbledhja e Simo Milutinoviçit⁹⁹ dhe disa këngë të mbledhura nga Mark Milani¹⁰⁰ etj.

Një qëndrim apriorist dhe tendencioz rreth përkimeve e afri-ve, përkatësisht huazimit të këngëve epike shqiptare nga ato në gjuhën serbokroate u shpreh dhe u përfill dhe nga disa auatorëve të tjerë, për të cilën gjë kemi bërë fjalë edhe në punimin kushtuar pikëpamjeve të Lamberzit kushtuar epikës gojore shqiptare.¹⁰¹

Studiuesi çek jep edhe disa të dhëna të tjera për trimat e epikës shqiptare si për Gjergj Elez Alinë,¹⁰² pastaj për traditën e vajtimit të Kuçët,¹⁰³ për traditën e çetimit dhe të këngës ndër kaçakët e Kosovës¹⁰⁴ etj.

⁹⁷ Selami Pulaha, *Kontribut për studimin e ngulitjes së katuneve dhe krijimin e fiseve në Shqipërinë e Veriut në shekujt XV—XVI*. Në: Studime historike, viti XXIX, nr. 1, Tiranë 1975, f. 75—107; Kahrëman Ulqini, *Tradita dhe historia rreth zanafillës shqiptare të disa fiseve malazeze*. Në: Kultura popullore, nr. 1, Tiranë 1983, f. 221—228.

⁹⁸ Disa autorë sjellin një varg të dhënash për mundësinë e ndikimit të vendasve të lashtë ballkanikë në kulturën e popujve sllavë të Jugut. Në gjuhësi këtë problem e trajtojnë D. Brozoviçi në veprën e tij *Doseljenje Slavena i njihovi dodiri sa starosjediocima u svetlu lingvističkih istraživanja*. Izd. ANUHIH XII, Sarajevo 1960, pastaj I. Popoviçi etj., ndërsa në etnografi A. Haberland, F. Nopsca, Sh. Kulishiçi etj.

⁹⁹ Shih fusnotën nr. 72.

¹⁰⁰ Marko Miljanov, *Pleme Kuçi u narodnoj priçi i pjesmi*. Beograd 1904. Shih, Marko Miljanov, *Sabrana djela*, knjiga 2, Titograd 1967.

¹⁰¹ Shih punimin kushtuar Lambertzit për epikën, pastaj punimin po ashtu në këtë vëllim „Për një qasje më të drejtë dhe për një studim më kompleks të epikës gojore të popujve të Siujdhesës Ballkanike” dhe Qemal Haxhihasani, *Vështrim kritik i disa koncepteve antishkencore rreth epikës sonë heroike legjendare*. Në: Kultura popullore nr. 2, Tiranë 1983, f. 31—44.

¹⁰² M. Murko, *Tragom...*, f. 233, 245, 274 etj.

¹⁰³ *Po aty*, f. 360.

¹⁰⁴ *Po aty*, f. 362 dhe 429.

6. Prania dhe përdorimi i foljes „knaditi, sknaditi dhe isknaditi” në Hercegovinë

Një problem që bëhet objekt trajtimi në shumicën e punimeve të Murkos është ai i përdorimit të foljes *knaditi*, *sknaditi*, *isknaditi* etj., të cilën e dëgjoji shpesh në terren, sidomos gjatë mbledhjes së këngëve në Hercegovinë. Për herën e parë këtë problem Murkoja e shtroi në punimin „Berich über eine Reise...”¹⁰⁵ të botuar më 1915-të. Në të theksohet se folja në fjalë është e lidhur ngushtë me procesin e këndimit dhe të krijimit të këngës. Këngëtarët, shkruan Murkoja, përdorin dhe nocione të tjera, por knaditi, isknaditi, sknaditi është shumë i përhapur dhe përdoret shpesh sidomos në Hercegovinë.¹⁰⁶ Këtë problem ai e trajtoi dhe në punimin „Neus über Südslavvische Volksepik”,¹⁰⁷ në veprën „Gjurmëve...”¹⁰⁸ dhe në mënyrë të veçantë në punimin „Folja knaditi”.¹⁰⁹

Në Fjalorin kroatisht ose serbisht (VII, 397) T. Maretiqi thotë se për fjalën *knaditi* s'ka verifikim të sigurt.¹¹⁰ Sa i përket etimologjisë së kësaj foljeje T. Maretiqi shkruan (Rječnik VII, 397) „duket se kjo folje nuk gjendet në gjuhët e tjera sllave, prandaj formimi është i errët”.¹¹¹ Edhe Murko thekson se kjo folje, që te kroatët dhe serbët është e përqendruar kryesisht në Hercegovinë, nuk gjendet në gjuhët e tjera sllave, pos në polonishte në formën „*knować, knuje*”. Fjalët e këtilla shton më tej Murko, shpesh mund të jenë të huaja. U mbetet ballkanologëve që t'ia gjejnë burimin.¹¹²

Për të parë se në ç'raste përdorohej kjo folje në gjithë Hercegovinën nga besimtarët e tri konfesioneve (katolikët, ortodoksët dhe myslimanët) Murkoja jep disa shemuj,¹¹³ nga të cilat, këtu po i përmendim vetëm disa: pjesmu isknaditi; knaditi — tekst stvoriti; odmah će sknaditi pismu; pjesmu sknaditi; znam sknaditi; ako knadim; da mu ja knadim pjesme; umije sastaviti... isknaditi pjesmu etj.

Mbas Murkos kjo folje u bë objekt trajtimi edhe i disa studuesve dhe shkencëtarëve të tjerë. Filologu klasik, Maximilian

¹⁰⁵ M. Murko, *Bericht über eine Reise...* Wien, 1915, f. 1—50.

¹⁰⁶ *Po aty*, f. 39.

¹⁰⁷ M. Murko, *Neues über Südslavische Volksepik*. Në: Homer. Tradition und Neuerung. Hg. von J. Latacz, Darmstadt, 1979, f. 139.

¹⁰⁸ M. Murko, *Tragom...*, f. 254, 262 („Zene u Smokvici na Korčuli kantaju”), 497, 509 etj.

¹⁰⁹ M. Murko, *Glagol knaditi*. Prilog leksikografiji i proučavanju narodne epike. Në: Zbornik u čast A. Belića, Beograd 1937, f. 225—229.

¹¹⁰ *Po aty*, f. 225.

¹¹¹ *Po aty*, f. 229.

¹¹² *Po aty*, f. 229.

¹¹³ *Po aty*, f. 226.

Lambertzi, i cili një kohë u mor me gjuhën latine, me atë greke, pastaj me gjuhën shqipe dhe me disa gjuhë të tjera, në studimin e tij të njohur. *Mbi epikën popullore të shqiptarëve* të botuar në revistën shkencore të Universitetit Karl-Marks të Lajpcihit¹¹⁴ më 1954—1955 (si botim i veçantë më 1958 në Halle-Saale),¹¹⁵ pos tjerash, e vështron këtë folje që e përmend Murkoja. Lambertzi thotë se folja knaditi, isknaditi, sknaditi nuk është as në fjalorin e V. Karaxhiqit. Duke e vështruar më për afër këtë folje ky studiues shkruan sa vijon: „Zweifellos haben wir hier das albnische Verb kndue, këndue, kandue „singen“. Die serbischen Sänger haben das albanische Berufswort übernommen in Sinn von „singen, efinden, ausschmücken, zusammenstellen, zusammenfügen, zuschneiden, schaffen“.¹¹⁶

Mendimi i studiuesit gjerman, M. Lambertzit, njërit ndër njohësit më të mirë të epikës gojore shqiptare, sidomos të këngëve kreshnike shqiptare, për burimin shqip të foljes në fjalë është i qëndrueshëm. Ne po sjellim edhe disa të dhëna të tjera, që e plotësojnë dhe e bëjnë dhe më të qëndrueshëm mendimin e Lambertzit, por edhe dëshmojnë se problemi i epikës gojore shqipe në krahasim me atë në gjuhën serbokroate, sidomos me atë myslimane, duhet parë në mënyrë shumë më komplekse, qoftë kur shtrohet problemi i afrisë dhe i ngjashmërisë, qoftë i përcaktimit të ndikimit të njërës epikë në tjetrën dhe të masës së këtij ndikimi në një drejtim ose në mënyrë të ndërsjellë.

Tashmë edhe shkencërisht është verifikuar fakti se shqiptarët janë të pranishëm në Hercegovinë, në Bosnë dhe në Dalmaci qysh herët, madje edhe para pushtimit turk. Për këtë prani dëshmojnë një varg të dhënash gjuhësore, onomastike, historike, etnografike etj., të cilat, kur vështrohen në lidhshmëri të ndërsjellë, mund të hedhin dritë për ndriçimin sa më të plotë të shumë problemeve të epikës gojore shqipe e serbokroate, por edhe të foljes knaditi, sknaditi, isknaditi, të cilën Murkoja thoshte se ishte e përhapur në gjithë Hercegovinën.

Në punimin „Prejardhja e popullit ortodoks në veriperëndim të Bosnës”,¹¹⁷ Vladislav Skariqi jep një varg të dhënash për prarinë e shumë emrave, patronimeve dhe toponimeve shqipe që janë të përhapura në shumë vise të Bosnës. Disa prej tyre pa

¹¹⁴ Maximilian Lambertz, *Die Volkspeik der Albaner*. Në: *Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl—Markx—Universität Leipzig* 4 (1954—55), f. 243—289; 439—473.

¹¹⁵ M. Lambertz, *Die Volksepik der Albaner*. Halle (Saale) 1958.

¹¹⁶ M. Lambertz, *vep. cit.* f. 130.

¹¹⁷ Vladislav Skarić, *Porijeklo pravoslavna naroda u sjeverozapadnoj Bosni*. Në: *Glasnik Zemaljskog muzeja Bosne i Hercegovine*. Urednik Dr. C. Truhelka. Sarajevo 1919, f. 219—265.

dyshim janë dhe të kohës paraturke si arbanasi etj. që me pushimin turk zëvendësohet me arnautët.¹¹⁸ Numri i emrave që ky studiues i nxjerr të burimit shqip, janë të shumtë¹¹⁹ dhe sjellja vetëm e një numri prej tyre këtu do të na largonte nga qëllimi i punimit.

Për gjurmët e shqiptarëve në Hercegovinë dëshmojnë shumë të dhëna të V. Qoroviçit, të botuara më 1923.¹²⁰ Ky studiues thekson se Jeriçeku ka bërë me dije për komunën e çobanëve — Burmazët (Burrmadhet) ose Burmazoviçët në Humë, që del nga shqip burrë i madh. Edhe disa nocione të fushës së blegtorisë (sipas J. Dedijerit) bala, qeno, keqa etj. janë po ashtu të burimit shqip. Në disa pjesë të Bregut të Drinit deri te Serbrenica kanë hyrë disa fjalë shqipe që janë ruajtur në të ashtuquajturin të folurit e fshehtë „banal”¹²¹ Një pjesë të gjurmëve shqiptare në Hercegovinë — shkruan më tej Qoroviçi — mund të shihen në disa emra vendesh — lokalitetesh, emra njerëzish dhe familjesh. Për këtë ai sjell disa shembuj si shqip zot — zotoviçët perendi — perdia. Për emrat Leka dhe Lekiq thotë se mjaft shpesh kanë trajtën shqipe;¹²² një pjesë e katundit Kërnjeviq në Shumën hercegovase quhet *arbanas*: pastaj ibalët; tyçepi (mes Neretvës dhe Markarskës) kanë analogjinë e Tuçepëve në afërsi të Dibrës etj. Qoroviçi thekson se këto vendbanime shqiptare duhet të jenë fort të vjetra.¹²³ Shumë nga këto të dhëna ky autor i përsërit edhe në veprën „Historia e Bosnës”.¹²⁴

Ndër shumë autorë, të cilët dëshmojnë për këtë prani, po veçojmë dhe Shpiro Kulishiçin. Ky studiues dhe njohës i shquar i Mesjetës në Ballkan dhe i kulturave të popujve të lashtë të Evropës Juglindore, në disa punime e vepra trajtoi rolin e vendasve të lashtë ballkanikë në kulturat e popujve që u vendosën më vonë në këtë pjesë të Evropës. Mendimin se popujt sllavë të Jugut kishin pësuar ndikim nga paraardhësit ballkanikë në fusha të ndryshme të organizimit të jetës, të dokeve e zakoneve, të veshjes etj., ky studiues e thelloi dhe e shpuri përpara. Duke pranuar mendimin se shtresa e lashtë e popullatës sllave „në shumë fise pranoi në vete dhe mbetje (mbeturira) të vendasve të lashtë të sllavi-

¹¹⁸ *Po aty*, f. 229.

¹¹⁹ *Po aty*, f. 225, 227, 229, 230, 231, 234, 235, 249, 252, 255, 258, 260, 264 etj.

¹²⁰ V. Čorović, *Napomene o albanskim tragovima u Hercegovini*. Në: Arhiv za arbanašku starinu, jezik i etnologiju. Knjiga I, sv. 1—2. Beograd 1923, f. 201—205.

¹²¹ *Po aty*, f. 202.

¹²² *Po aty*, f. 203.

¹²³ *Po aty*, f. 204.

¹²⁴ Dr. Vladimir Čorović, *Historija Bosne*. Prva knjiga. Beograd 1940, f. 107, 108 etj. Ky autor edhe fjalën Bosnë e nxjerr prej fjalës shqipe bos, boss. Shih pjesën *Prehistorijsko doba* në veprën e përmendur, f. 47.

zuar, të vëllehëve dhe shqiptarëve” thekson ndër të tjera se „Përkundër mendimit të shumë shkencëtarëve për prejardhjen sllave të disa institucioneve dhe formave familjare shqiptare, hulumtimi më i përafërt tregon se shoqëria familjare shqiptare, për nga shumë tipare esenciale, është më arkaike dhe më shumë autoktone nga kjo jona, e cila vërtet për shumçka është zhvilluar mbi bazën dhe nën ndikimin e organizimit të lashtë familjar ballkanik”.¹²⁵ Në disa punime të tjera dhe në librin „Mbi etnogjenezën e malazezve”¹²⁶ Kulishiçi sjell disa të dhëna të ndikimit të kulturës shqiptare në kulturën e disa popujve sllavë, në mënyrë të veçantë të malazezve. Pos tjerash, ai përmend një varg emrash të familjeve shqiptare që gjenden në Hercegovinë dhe Bosne si Mataranga¹²⁷ (në burimet e Dubrovnikut të shek. XIII dhe XIV-të përmenden princat shqiptarë Matarangët; po ashtu Jeriçeku thekson se para ardhjes së turqve përmenden aristokratët shqiptarë — Matarangët) Zotoviqët, Bukumirët, Ibalët, Burmazët, familja Shurdhani etj. Rreth kësaj Kulishiçi shkruan: „Shumë autorë tregojnë për atë që në përbërjen e popullatës jo sllave të Malit të Zi dhe të Hercegovinës, primesa etnike shqiptare ishte evidente”.¹²⁸ I vetëdijshëm për një ndikim të këtillë të kulturës shqiptare në atë malazeze-hercegovase, Kulishiçi do ta përmbyllë punimin e tij „Substrati ballkanik në organizimin e familjes dinarike” me këtë konstatim: „... organizimi i familjes sonë dinarike, sidomos ajo malazeze-hercegovase, si tërësi i ka tiparet e veta specifike me të cilat, në strukturën e vet dhe në zhvillimin e vet, ndryshon nga marrëdhëniet familjare historikisht të njohura dhe nga tradita e përgjithshme familjare e popujve të tjerë sllavë. Organizimi i familjes sonë dinarike për shumë elemente arkaike i përgjigjet strukturës dhe traditës së organizimit familjar-fisnor të disa popujve të Kavkazit dhe jermenëve, e cila qartas sugjeron për gjurmët e lashta të substratit paleoballkanik. Në anën tjetër, shumë dukuri të organizimit familjar malazezo-hercegovas më përafër i përgjigjen strukturës së shoqërisë familjare shqiptare, e cila për shumë tipare thelbore del shoqëri më origjinale dhe

¹²⁵ Špiro Kulišić, *O nekim problemima etničkog razvitka našeg dinarkog stanovništva i njegovih odnosa sa balkanskim starincima*. Në: Godišnjak Knjiga V, Centar za balkanološka istraživanja, knjiga 3. (ANU-BiH. Sarajevo 1967, f. 198.

¹²⁶ Špiro Kulišić, *Neki problemi u predanjima o starom stanovništvu dinarske oblasti*. Në: Godišnjak, Knjiga V. Centar za balkanološka istraživanja, knjiga 3, Sarajevo 1967, f. 233—241; Špiro Kulišić, *Balkanski supstrat u dinarskoj rodovskoj organizaciji*. Në: Godišnjak, Knjiga XIII. Centar za balkanološka istraživanja, knjiga 11, Alojz Benac sexagenario dictvm, Srajevo 1976, 361—374; Špiro Kulišić, *O otnogenezu crnogoraca*, Titograd 1980.

¹²⁷ Š. Kulišić, *Neki problemi...* i cit. f. 237.

¹²⁸ *Po aty*, f. 237.

më arkaike, me mbeturira specifike, herë-herë shumë arkaike të marrëdhënieve parapatriarkale, që përkon me traditën paraindo-evropiane".¹²⁹

Në goftë se burimin shqip të foljes knaditi, sknaditi, isknaditi (nga kndue, këndue, kandue sipas Lambertzit) e vështrojmë dhe e përastrojmë në dritën e të dhënave që i sollëm më lart rreth lashtësisë, autoktonisë dhe arkaizmit të kulturës shqiptare dhe të ndikimit të saj në disa fusha të kulturës së disa popujve sllavë, sidomos në Mal të Zi, në Hercegovinë dhe në Bosnë — atëherë jo vetëm që ky mendim bëhet i qëndrueshëm dhe përhapja e kësaj foljeje në gjithë Hercegovinën dhe në Bosnë del si një dukuri e zakonshme, madje dhe e natyrshme, por këto të dhëna dëshmojnë po ashtu se sa Murkoja (madje jo vetëm ky) ishte larg njohjes së epikës gojore shqipe dhe larg çështjeve esenciale të përhapjes dhe të ekzistimit të saj, sidomos kur epika gojore shqiptare vështrohej në dritën e përkimeve, afrisë, ngjashmërisë dhe të mundësisë së ndikimit njëdrejtimsh ose të ndikimit të ndërsjellë.

* * *

Nga gjithë kjo që thamë mund të nxjerrim përfundimin përmbledhës se të dhënat e M. Murkos për poezinë gojore shqipe, edhe pse herë-herë jo të plota dhe të pakta, kanë rëndësi për historinë e letërsisë gojore shqipe e në mënyrë të veçantë për epikën e saj. Ato në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë japin një pasqyrë sado modeste të përhapjes dhe të kultivimit të këngës epike të shqiptarët në dekadat e para të shekullit tonë, në një hapësirë mjaft të madhe gjeografike. Të dhënat për kultin ndaj këngës, për këngëtarët si dhe për këngëtarë që këndonin në dy gjuhë (shqip e serbokroatisht, shqip e turqisht) janë të rëndësishme për historikun e epikës gojore të popujve të Evropës Juglindore, e në mënyrë të veçantë për studimin e afrive, ngjashmërive, përkimeve dhe mundësisë së ndikimit të njërës epikë në tjetrën ose të ndikimit të ndërsjellë të tyre. Të dhënat e Murkos për epikën gojore shqiptare, kur përastrohen dhe plotësohen me ato të studiuesve të tjerë të huaj për këtë epikë, si të M. Lambercit, F. Kordinjanos, A. Shmausit, M. Perit, A. Lordit etj., atëherë bëhen më të vlefshme dhe më të rëndësishme.¹³⁰

¹²⁹ Š. Kulišić, *Balkanski supstrat...* i cit. f. 374.

¹³⁰ Një pjesë e literaturës, e përdorur për këtë punim, nuk u citua në fusnota, si fjala vjen punimi i A. Lordit *Homer i Huso* (përkthim nga anglishtja), „The effect of the Turkish conquest on Balkan epik tradition” (Mouton 1972), „The making of Homeric Verse”. The collected papers of Milman Parry (Edited by Adam Parry), Oxford 1971 sidomos „Cor Huso: A Study of Southslavic Song” nga f. 437—464 etj.

Anton Berisha

L'IMPORTANCE DES REFLEXIONS DE MATTHIAS MURKO
SUR LA POÉSIE ORALE ALBANAISE

Résumé

Durant ses recherches sur l'épique orale des Slaves du Sud, Matthias Murko nous a laissé quelques notes sur l'épique orale albanaise qu'il eut l'occasion de connaître en différents lieux, notamment en Kossova dans le Plateau de Dukagjin, au Monténégro, à Novi Pazar ect. Murko a présenté quelques réflexions sur cette poésie et enregistré des chants épiques interprétés selon la manière albanaise.

Ce travail expose longuement la contribution de Murko dans le domaine de la littérature orale albanaise (il analyse les travaux de Murko en langue serbo-croate publiés à partir de 1908, et surtout ceux de son ouvrage bien connu sur l'épique populaire serbo-croate: „Tragom srpskohrvatske narodne epike” 1951). Il étudie la poésie orale chez les Albanais, son niveau artistique, ses thèmes, la manière traditionnelle de chanter dans les deux langues (albanais et serbo-croate et parfois aussi turc). Il mentionne le chanteur aveugle Qorr Husen, observe les correspondances et les exemples de poésie épique albanaise orale qu'il compare aux chants épiques des Slaves du Sud. Il fait ensuite des observations sur les parlers ekavien, yekavien, ikavien. Dans cet exposé nous avons contesté et complété les réflexions de Murko sur l'épique albanaise, nous avons examiné les circonstances qui ont conditionné la partialité et la vérification des observations du savant tchèque. Nous nous sommes donc opposé à certaines opinions étroites et insoutenable de Murko sur l'épique albanaise, et nous avons apporté de nouveaux et solides arguments dont le savant tchèque n'avait pas tenu compte. Certaines constatations de Murko sont en relation avec différentes opinions sur la poésie orale albanaise correspondant au niveau de développement de l'étude de l'épique orale de l'Europe du Sud — Est. Ceci impose la nécessité d'examiner et de réexaminer le complexe de l'épique orale des peuples de cette partie de l'Europe.

Les réflexions de Murko sur la poésie épique orale albanaise ont naturellement une grande importance pour l'histoire de son développement, surtout lorsqu'elles sont complétées par les études d'autres savants étrangers (M. Lambertz, F. Cordignano, A Schmaus, M. Parry, Lord ect) et actuellement albanais.